



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:188904
Datë: 06.03.2025
Numri i dokumentit: 06947590

C.nr.6602/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Shpresa Veselaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve E. H, A. V, D. C, V. H, dhe T. Z, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson L. M, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti për kompensimin në bazë të kualifikimit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 06.03.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

P a s h q y r t i m k r y e s o r t ë ç ë s h t j e s

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëseve E. H, A. V, D. C, V. H, dhe T. Z, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Prishtinës- Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, që paditëseve, t'ua kompensoj shumat si në vijim:

- E. H, në emër të licencimit-kualifikimit në vlerë të 27% për periudhën kohore 01.09.2018 – 31.12.2021, (40 muaj x 55.35 €) t'ia paguaj në shumë prej 2,214.00€;
- A. V, në emër të licencimit-kualifikimit në vlerë të 27% për periudhën kohore 01.09.2018 – 31.12.2021, (40 muaj x 55.35 €) t'ia paguaj në shumë prej 2,214.00€;
- V. H, në emër të licencimit-kualifikimit në vlerë të 27% për periudhën kohore 01.09.2018 – 31.12.2021, (40 muaj x 55.35 €) t'ia paguaj në shumë prej 2,214.00€;
- D. C, në emër të licencimit-kualifikimit në vlerë të 27% për periudhën kohore 01.09.2018 – 31.12.2021, (40 muaj x 55.35 €) t'ia paguaj në shumë prej 2,214.00€;
- T. Z, në emër të licencimit-kualifikimit në vlerë të 27% për periudhën kohore 01.09.2018 – 31.12.2021, (40 muaj) t'ia paguaj në shumë prej 2,214.00€.

E të gjitha këto me kamatë prej 8 % nga marrja e këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që ti paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 644.00 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me detyrim.

III. REFUZOHET sie pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëseve sa ka të bëjë me periudhën nga data 18.04.2017 deri me datë 01.09.2018 në shumë prej 1,080.00 për secilin paditës veç e veç.

A r s y e t i m

Paditëset përmes të autorizuarit të tyre, më datë 11.08.2021 kanë paraqitur padi në këtë gjykatë, për kompensim e diferencës së pagave mbi bazën e kualifikimit. Në padi kanë theksuar se paditëset janë në marrëdhënie pune në cilësinë e mësimdhënës në SH.F.M.U “M. B,” në Prishtinë. Tutje ka shtuar se paditësja e parë ka kualifikimin bachelor, paditësja e dytë ka kualifikim bachelor i biologjisë, paditësja e tretë ka kualifikim profesor, paditësja e katërt e ka kualifikim bachelor i programit fizik-kimi, paditësja e pestë ka kualifikimin profesor i artit muzikor. Tutje, kanë theksuar se deri më tani, paditëseve në emër të kualifikimit i është paguar shuma prej 58.32 €, ashtu që ka mbetur pa iu paguar diferenca prej 55.35 € për çdo muaj, edhe përkundër plotësimin të kushteve të përcaktuara në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë në fuqi nga data 18.04.2017, pasi që bazuar në këtë shihet qartë se e paditura nuk ka kompensuar si duhet detyrimin ligjor sipas kësaj Kontrate, respektivisht nenit 7 të saj. Me tutje kane shtuar se paditëseve në bazë të nenit 7 për Licencim pika 1.5 përcakton se “përparimet në karrierë caktohet lartësia e pagës dhe lëvizja në gradim që përcillet me ngritje pagës prej 10%. Ka theksuar se përveç Kontratave Kolektive të lartcekura, kërkesëpadiat e paditësve gjenë mbështetje edhe në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008, respektivisht pikën 3 të këtij Vendimi. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadiat e paditëseve dhe të detyrohet e paditura që paditësës së parë E. H,- në emër të licencimit-kualifikimit për 27% të pagës bazë për periudhën kohore 01.09.2018 – 31.12.2021 në emër të diferencës së papaguar, në pagë në bazë të kualifikimit (40 muaj) t’ia paguaj në shumë prej 2,214.00€, paditësës së dytë A. V, - në emër të licencimit-kualifikimit për periudhën kohore 01.09.2018 – 31.12.2021, (60 muaj) t’ia paguaj në shumë prej 3,321.00€, paditësës së tretë D. C,- në emër të licencimit-kualifikimit për periudhën kohore 01.09.2018 – 31.12.2021, (60 muaj) t’ia paguaj në shumë prej 3,321.00€, paditësës së katërt V.H, në emër të licencimit-kualifikimit për periudhën kohore 01.09.2018 – 31.12.2021, (60 muaj) t’ia paguaj në shumë prej 3,321.00€, paditësës së pestë T. Z, në emër të licencimit-kualifikimit për periudhën kohore 01.09.2018 – 31.12.2021, (60 muaj) t’ia paguaj në shumë prej 3,321.00€, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datë 31.12.2021, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë. Me propozim për gjykatën që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar .

E paditura me përgjigje në padi, të dorëzuar në gjykatë më datë 16.09.2022, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëseve, fillimisht mbi bazën e pretendimit se paditëset nuk kanë ofruar prova që i ka shterrur të gjitha mjetet juridike para se t’i drejtohet Gjykatës me padi, ashtu siç është e paraparë me nenin 78 par.1 të Ligjit të Punës, duke pretenduar në këtë mënyrë se: ”I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur te drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë të punë dhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura”. Tutje pretendohet se kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, e po ashtu theksohet se e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për këtë lloje të kompensimit. Po ashtu, ka theksuar se në rastin

konkret ekziston edhe parashkrimi i kërkesës, pasi që konform dispozitave të Ligjit të Punës, të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 (tri) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, i ka propozuar Gjykatës që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditëseve ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, mirëpo nga e paditura mbetet kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë dhe si rezultat i mungesë së linjës buxhetore për kërkesat e tilla. Gjykata vlerëson se nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Ndërsa për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë, gjykata vendosi konform nenit 399 të LPK-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, siç vërtetohet edhe nga kontratat e punës së paditëseve. mirëpo kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ka qenë e drejta e realizimit të kërkesave në lidhje me diferencën e shtesave të papaguara në emër të kualifikimit.

Nga kontrata e punës për stafin arsimor në kohë të pacaktuar, me nr. 109, të datës 01.09.2018, konstatoi se paditësja e parë E. H, është në marrëdhënie pune tek e paditura në vendin e punës si mësimmhënëse e mësimit klasor në Institucionin arsimor SH.F.M.U “M. B” në Prishtinë. Në bazë të listës së pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, me numër të punëtorit: EM00096156, vërtetohet se paditësja e ka pagën bazë mujore në shumë prej 421.00 € dhe se paditëses në emër të kualifikimit i është paguar shuma prej 58.32 €. Nga Diploma Nr.2503, e datës 02.12.2015, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, rezulton se paditësja ka marrë titullin Bachelor i programit Fillor. Ndërsa, në bazë të Licencës së mësimmhënësit e lëshuar me datë 02.12.2015 nga MASHT, rezulton se paditësja është e licencuar me Licencë të Rregullt Karriere.

Paditësja e dytë A. V, është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimmhënëse e lëndës së biologjisë në Institucionin arsimor SH.F.M.U “M. B,” në Prishtinë. Një fakt i tillë, vërtetohet sipas Kontratës së Punës me numër protokollit 662/34/11, të datës 27.04.2015. Në bazë të listës së pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, me numër të punëtorit: EM00109807, vërtetohet se paditësja e ka pagën bazë mujore në shumë prej 421.00 € dhe paditëses në emër të

kualifikimit i është paguar shuma prej 58.32 €. Nga Diploma Nr.1785, e datës 31.05.2021, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” - Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, rezulton se paditësja ka marrë titullin Bachelor i Biologjisë-Kimisë, ndërsa në bazë të Licencës së mësimdhënësit Nr.100016835 e lëshuar me datë 13.06.2018 nga MASHT, konstaton se paditësja është e licencuar me Licencë të Rregullt Karriere.

Paditësja e tretë V. H, është në marrëdhënie pune tek e paditura, si profesorësh e lëndës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Institucionin arsimor SH.F.M.U “M. B” në Prishtinë. Një fakt i tillë, vërtetohet sipas Kontratës së Punës me numër protokoll 108, të datës 01.04.2019. Në bazë të listës së pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, me numër të punëtorit: EM00004942, vërtetohet se paditësja e ka pagën bazë mujore në shumë prej 421.00 € dhe se paditëses në emër të kualifikimit i është paguar shuma prej 58.32 €. Nga Certifikata, nr.prot 04/1335 e datës 28.09.1991, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjik në Prishtinë, vërtetohet se paditësja ka marrë titullin profesor, ndërsa, në bazë të Licencës së mësimdhënësit Nr.1024422 e lëshuar me datë 21.09.2015 nga MASHT, rezulton se paditësja është e licencuar me Licencë të Rregullt Karriere.

Paditësja e katërt D. C, është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse e lëndës së Fizikes në Institucionin arsimor SH.F.M.U “M. B” në Prishtinë. Një fakt i tillë, vërtetohet sipas Kontratës së Punës me numër protokoll 1157/20, të datës 24.03.2015. Në bazë të listës së pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, me numër të punëtorit: EM00023564, vërtetohet se paditësja e ka pagën bazë mujore në shumë prej 421.00 € dhe se paditëses në emër të kualifikimit i është paguar shuma prej 58.32 €. Nga Certifikata Nr.547, e datës 26.03.2015, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, vërtetohet se paditësja ka marrë titullin Bachelor i Programit Fizike-Kimisë, ndërsa, në bazë të Licencës së mësimdhënësit Nr.100016832 e lëshuar me datë 13.06.2013 nga MASHT, rezulton se paditësja është e licencuar me Licencë të Rregullt Karriere.

Paditësja e pestë T. Z, është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse e kulturës muzikore Institucionin arsimor SH.F.M.U “M. B,” në Prishtinë. Një fakt i tillë, vërtetohet sipas Kontratës së Punës me numër protokoll 657/70, të datës 27.04.2015. Në bazë të listës së pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, me numër të punëtorit: EM00023564, vërtetohet se paditësja e ka pagën bazë mujore në shumë prej 421.00 € dhe se paditëses në emër të kualifikimit i është paguar shuma prej 58.32 €. Nga vërtetimi Nr.1790, e datës 10.02.2004, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Arteve në Prishtinë, rezulton se paditësja ka marrë titullin profesor i artit muzikor, ndërsa, në bazë të Licencës së mësimdhënësit Nr.100016832 e lëshuar me datë 13.06.2013 nga MASHT, vërtetohet se paditësja është e licencuar me Licencë të Rregullt Karrierë.

Sipas nenit 329 par. 1 të LPK-së: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”* Së këndejmi, provave që kishin të bënin me vërtetimin e fakteve lidhur me marrëdhënien e punës, lartësinë e pagës dhe kompensimin për kualifikim, Gjykata ia fali besimin e plotë, sepse është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Në raport me bazën juridike të mbështetjes së kërkesëpadisë, Gjykata fillimisht iu referua Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të lidhur me datë 18.04.2017, me rastin e nënshkrimit nga Organizatat e të Punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës), si dhe

Qeverisë së Republikës së Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë), e cila Kontratë ka gjetur zbatim për periudhën kohore 18.04.2017 - 21.01.2021. Dispozita nga neni 7, pika 1.3 dhe 1.4 e Kontratës së lartcekur, përcakton që: *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.3. Mësimdhënësit me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë; 1.4. Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçare, magjistraturë/master dhe doktoraturë 35% të pagës bazë.”*

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të mbështetjes së kërkesëpadisë, Gjykata po ashtu iu referua edhe Vendimit Nr.01/33, të datës 29.08.2008, të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ku në pikën 3 të këtij Vendimi shprehimisht përcaktohet që: *“Ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillor dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës”*. Pika 4 e të njëjtit vendim përcakton që: *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur: Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagesës bazë prej 27%; Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoratë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.”*

Gjykata iu referua edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A-Su.A, 214/2023, të datës 09.10.2023, specifikisht pikës I të këtij Mendimi, ku përcaktohet: *“Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008.”* Në arsyetim të këtij Mendimi Juridik është sqaruar se Vendimi i lartcekur ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.2023, (kur edhe është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik Nr.08/L-196), ndërsa tutje është sqaruar edhe fakti se mbështetja e kërkesëpadisë për kompensim mbi bazën e kualifikimit në këtë Vendim nga ana e mësimdhënësve është në shërbim të sigurisë juridike.

Gjykatës vlerëson se paditëset janë pajisur me licencë të mësimdhënësve të karrierës dhe kanë fituar titullin në lëminë përkatëse. Në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e pagës mbi bazën e kualifikimit përfshin periudhën kohore 11.04.2021 – 06.02.2023, periudhë kjo gjatë së cilës Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/33, i datës 29.08.2008 ka qenë në fuqi, gjegjësisht ka prodhuar efekte juridike. Mbi këtë bazë, e njëjta mund t'i gëzojë benefitet e përcaktuara me Vendimin e lartcekur, respektivisht të drejtën e përfitimit të ngritjes së pagës bazë në vlerën prej 27% mbi bazën e kualifikimit, të përcaktuar në pikën 4 të Vendimit të lartcekur.

Mbi këtë bazë, për secilën prej paditëseve është bërë përlllogaritja si më poshtë:

Për paditësen E. H, fillimisht është përlllogaritur vlera prej 27% e pagës bazë së paditëses (421.00 x 27%), nga e cila përlllogaritje ka dalë shuma prej 113,67 €. Nga shuma e lartcekur është zbritur shuma në vlerë prej 58.55 €, e cila i është kompensuar paditëses në kuadër të pagës mujore, ndërsa ka ngelur shuma prej 55.35 €. Meqenëse pjesa e kërkesëpadisë së paditëses përfshin periudhën kohore prej 40 muaj, vlera e lartcekur (55.35 €) është shumëzuar me numrin 40, ashtu që $55.35€ \times 40 = 2,214.00€$, nga e cila rezulton se paditëses i takon e drejta në kompensim në shumën e përgjithshme prej 2,214.00 €.

Për paditësen A. V, fillimisht është përlllogaritur vlera prej 27% e pagës bazë së paditëses (421.00 x 27%), nga e cila përlllogaritje ka dalë shuma prej 113,67 €. Nga shuma e lartcekur është zbritur

shuma në vlerë prej 58.55 €, e cila i është kompensuar paditëses në kuadër të pagës mujore, ndërsa ka ngelur shuma prej 55.35 €. Meqenëse pjesa e kërkesëpadisë së paditëses përfshin periudhën kohore prej 40 muaj, vlera e lartcekur (55.35 €) është shumëzuar me numrin 40, ashtu që $55.35€ \times 40 = 2,214.00€$, nga e cila rezulton se paditëses i takon e drejta në kompensim në shumën e përgjithshme prej 2,214.00 €.

Për paditësen D. C, fillimisht është përlogaritur vlera prej 27% e pagës bazë së paditëses (421.00 x 27%), nga e cila përlogaritje ka dalë shuma prej 113,67 €. Nga shuma e lartcekur është zbritur shuma në vlerë prej 58.55 €, e cila i është kompensuar paditëses në kuadër të pagës mujore, ndërsa ka ngelur shuma prej 55.35 €. Meqenëse pjesa e kërkesëpadisë së paditëses përfshin periudhën kohore prej 40 muaj, vlera e lartcekur (55.35 €) është shumëzuar me numrin 40, ashtu që $55.35€ \times 40 = 2,214.00€$, nga e cila rezulton se paditëses i takon e drejta në kompensim në shumën e përgjithshme prej 2,214.00 €.

Për paditësen V. H, fillimisht është përlogaritur vlera prej 27% e pagës bazë së paditëses (421.00 x 27%), nga e cila përlogaritje ka dalë shuma prej 113,67 €. Nga shuma e lartcekur është zbritur shuma në vlerë prej 58.55 €, e cila i është kompensuar paditëses në kuadër të pagës mujore, ndërsa ka ngelur shuma prej 55.35 €. Meqenëse pjesa e kërkesëpadisë së paditëses përfshin periudhën kohore prej 40 muaj, vlera e lartcekur (55.35 €) është shumëzuar me numrin 40, ashtu që $55.35€ \times 40 = 2,214.00€$, nga e cila rezulton se paditëses i takon e drejta në kompensim në shumën e përgjithshme prej 2,214.00 €.

Për paditësen T. Z, fillimisht është përlogaritur vlera prej 27% e pagës bazë së paditëses (421.00 x 27%), nga e cila përlogaritje ka dalë shuma prej 113,67 €. Nga shuma e lartcekur është zbritur shuma në vlerë prej 58.55 €, e cila i është kompensuar paditëses në kuadër të pagës mujore, ndërsa ka ngelur shuma prej 55.35 €. Meqenëse pjesa e kërkesëpadisë së paditëses përfshin periudhën kohore prej 40 muaj, vlera e lartcekur (55.35 €) është shumëzuar me numrin 40, ashtu që $55.35€ \times 40 = 2,214.00€$, nga e cila rezulton se paditëses i takon e drejta në kompensim në shumën e përgjithshme prej 2,214.00 €.

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditëset nuk kanë pranuar në tërësi kompensimin në emër të kualifikimit për 27 % të pagës bazë, e drejtë kjo e përcaktuar me vendimin Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008.

Bazueshmëria e kërkesëpadisë së paditëseve ka mbështetje në Vendimin me numër nr.01/33, të datë 29.08.2008, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ashtu që në pikën 3 të këtij Vendimi përcaktohet se “ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillorë dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës”, ndërsa në pikë 4 thuhet se mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur me, pika 3.3. “**Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 % dhe pika 4.3 “me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagesës bazë prej 27%”.**

Kërkesëpadia e paditëseve bazohet në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008, respektivisht pika 3 dhe pika 4, nga i cili Vendim të paditurës ka lindur detyrimi për kompensimin e diferencës në pagë të palët paditëse, për më tepër vetë pala e paditur në mënyrë të heshtur e ka paguar pjesërisht këtë detyrim ndaj paditëseve, në momentin që e njëjta i ka paguar për çdo muaj paditëseve në emër të kualifikimit pjesërisht detyrimin e mbetur borxh ndaj paditëseve.

Duke qenë se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin ndaj paditëseve, ku sipas dispozitës së nenit 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) parashihet se *“kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, ndaj gjykata në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, e detyroi të paditurën që paditëseve veç e veç t’ua kompensoj shumat e gjykuara, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të gjykatës ishin pretendimet e të paditurës se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar. Gjykata gjeti se pretendimi i te paditurës është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesëpadiës, gjykata ka vendosur bazuar në dispozitën e nenit 399 sipas të cilit *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndaj gjykata pjesërisht e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëseve, kjo pikërisht për arsye se gjykata konstatoi se një pjesë e kërkesës e paditëseve për periudhën kohore nga dt. 01.01.2017 deri me dt. 01.09.2018 në shumë prej 1,080.00 €, deri me paraqitjen e padisë në gjykatë me dt. 11.08.2021, është përfshirë me parashkrim, duke qenë se kanë kaluar 3 vite. Gjë që ka ardhur deri te parashkrimi sipas nenit 87 të Ligjit të punës të Kosovës.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së, e cila do të llogaritet nga marrja e këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive.

Vendimi që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, është bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe 452 e LPK-së, në shumë të përgjithshme prej 644.00€ (dhe atë 624.00 € në emër të përpilimit të padisë dhe shumën prej 20.00 € për taksën gjyqësore), ndërsa refuzoj pjesën tjetër të shpenzimeve pasi që të njëjtat, nuk kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në këtë gjykatë, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 453 par.1 të LPK-së.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.6602/21, datë 06.03.2025

Gjyqtarja
Shpresa Veselaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit për Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:188904
Datë: 06.03.2025
Numri i dokumentit: 06947590